

Vendim nr. 259 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SAIMIRA ÇOLLAKU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 522, datë 10.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-4306, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 107, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Saimira Çollaku ka ushtruar detyrën e drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave Arsimore në Institutin e Zhvillimit të Arsimit Tiranë. Ndërkohë, me urdhrin nr. 18, datë 27.02.2014 (*urdhri nr. 18/2014*) të drejtorit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit Tiranë, asaj i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, duke u larguar nga kjo detyrë, duke iu ndërprerë edhe marrëdhëniet financiare. Në këto kushte, kërkuesja i është drejtuar gjykatës kompetente me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e urdhrit nr. 18, datë 27.02.2014, detyrimin e të paditurit t'i njohë asaj statusin e nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese dhe pagesën e pagës deri në rikthimin në detyrën e drejtores.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 3037, datë 09.06.2014, ka vendosur: “Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, urdhrit nr. 18/2014, dhe detyrimin e palës së paditur të vazhdojë marrëdhënien e punës dhe trajtimin financiar të paditëses (kërkueses) në pozicionin e drejtores së Zhvillimit të Politikave Arsimore në Institutin e Zhvillimit të Arsimit Tiranë që nga data e nxjerrjes së këtij akti e në vijim. Detyrimin e palës së paditur dhe personit të tretë, Departamentit të Administratës Publike (*DAP*), që brenda afateve ligjore të ligjit nr. 152/ 2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*) dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij të nxjerrin aktin përkatës administrativ të konfirmimit nëse paditësja përmbush ose jo kriteret për fitimin e statusit të nëpunësit civil. Rrëzimin e padisë për sa i përket pjesës tjetër të kërtimeve, si kërkime të pabazuara në ligj.”. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur ankim pala e paditur, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, si dhe personi i tretë, *DAP*-i, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, ndërsa kërkuesja i ka paraqitur apel kundërshtues, duke kërkuar mospranimin e ankimeve të bëra nga i padituri dhe personi i tretë, si dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 522, datë 10.03.2014 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës me 5 (pesë) paga mujore. Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës me 1 (një) pagë mujore. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.”. Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs të gjitha palët në proces.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4306, datë 12.10.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë.

5. Në datën 23.08.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në të njëjtën datë.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:
- 6.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, duke prishur vendimet e gjykatave më të ulëta dhe duke e shqyrtuar atë në themel, kur ajo duhet ta kishte kaluar në seancë plenare për të dëgjuar palët ose për t'i njoftuar ata për të paraqitur parashtrimet.
- 6.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk arsyeton shkakun pse mbështet qëndrimin e gjykatës së apelit në lidhje me mbrojtjen ligjore të palës paditëse. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të interpretojë nenin 67 të ligjit nr. 152/2013. Ky nen e ka parashikuar qartë dhe saktë se kur punonjësit ekzistues, siç është rasti i kërkueses, janë nëpunës civilë. Kolegji Administrativ ka bërë një interpretim të gabuar të ligjit nr. 152/2013 dhe duhet të interpretonte nenin 67 të atij ligji, e cila është një dispozitë e qartë. Kërkuesja i plotëson të gjitha kushtet që ka parashikuar kjo dispozitë (neni 67 i ligjit nr. 152/2013). Gjithashtu, ai kolegji nuk ka vlerësuar interpretimin e ligjit nr. 152/2013 të bërë nga gjykata e shkallës së parë. Interpretimi i ligjit nr. 152/2013 nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë dhe nga gjykata e apelit është i gabuar dhe në kundërshtim me Kushtetutën. Kolegji Administrativ nuk ka vlerësuar argumentimin dhe interpretimin e ligjit nr. 152/2013 nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ka dhënë asnjë fakt se përse zbatohet Kodi i Punës. Neni 67 i ligjit nr. 152/2013 i jep kërkueses mbrojtje ligjore dhe kushtetuese, të cilën gjykatat ia kanë mohuar.
- 6.3. *Parimi i kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Administrativ duhet ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore për të dëgjuar palët.
- 6.4. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi është cenuar besueshmëria nga gjykimet e gjykatave, për shkak se kërkuesja është subjekt i ligjit nr. 152/2013.
- 6.5. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak se jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se gjykimi që zhvillohet në Gjykatën e

Lartë, lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta.

6.6. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi kundër kërkueses në proces janë institucionet shtetërore.

6.7. *E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2016 dhe janë tejkualuar afatet e gjykimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën

vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2023-4306, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 23.08.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra pas 10 muajve. Nga komunikimi elektronik i datës 30.09.2024, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesja është publikuar në faqen e saj zyrtare, duke u bërë i disponueshëm për palët në datën 21.02.2024, datë nga e cila deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual kanë kaluar rreth 6 muaj.

12. Në lidhje me këtë fakt, kërkuesja ka argumentuar se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor. Si provë për të mbështetur këtë pretendim, kërkuesja ka paraqitur një kërkesë të nënshkruar prej saj, e cila mban datën 22.01.2024 dhe me të cilën pretendon se i është drejtuar Gjykatës së Lartë për të tërhequr vendimin që ka kundërshtuar, duke i bashkëlidhur asaj dhe një fotokopje të vërtetimit postar, për dorëzimin e kërkesës në atë gjykatë. Sipas kërkueses, duke qenë se Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje kësaj kërkesë, ajo është paraqitur pranë sekretarisë së saj (Gjykatës së Lartë) në datën 26.04.2024 për të tërhequr një kopje të vendimit. Për këtë arsye, ajo pretendon se nga kjo datë (26.04.2024) fillon të llogaritet afati ligjor 4-mujor.

13. Ndërkohë, referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Kolegji konstaton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i është komunikuar kërkueses në datën 22.02.2024, në adresën e saj elektronike (*e-mail*), si edhe në atë të përfaqësuesit të saj, shtetasit F.Ç.

14. Për sa më lart, duke analizuar argumentet e paraqitura nga kërkuesja në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji vlerëson së llogaritja e afatit ligjor 4-mujor për efekt të paraqitjes së ankimit kushtetues individual do të konsiderohet data 22.02.2024, kur vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i është komunikuar me anë të njoftimit elektronik kërkueses dhe përfaqësuesit të saj. Në këtë kuptim, duke iu referuar kësaj date, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesja nuk plotëson kriterin *ratione temporis*, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesja nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.